



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 259/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-66246-01-31-2017 me objekt: “Rivitalizim i rrugës “Blv Blu” Urbane Kamëz”, me fond limit 86,818,451 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 24.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

“Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k.
Rruga “Don Bosko”, Pallati Meld, Kati II, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz
“Blv Blu”, nr.492 Kamëz, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 31.01.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-66246-01-31-2017 me objekt: “*Rivitalizim i rrugës “Blv Blu” Urbane Kamëz*”, me fond limit 86,818,451 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 24.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 24.02.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.03.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Caushi	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku	79,037,818	I skualifikuar
- Sireta 2F&Alko Impex General Construction	80,000,000	I skualifikuar
- Kacdedja&Agri Construction	81,584,629	I skualifikuar
- BO Krajger Konstruksion&Varaku E	89,950,061	I kualifikuar

II.4. Në datën 13.03.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

- *Nuk janë paraqitur listpagesat e muajit Janar 2017*
- *Automjeti me targa AA348AG i ka skaduar afati i certifikatës së kontrollit teknik si dhe siguracioni*
- *Automjeti me targa AA176HJ është automjet tip fuoristrade.*
- *Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontratë huaje por që është dhënë nga qerramarrësi për qëllime bamirësie*
- *BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer, Pirun, Makinerive televizë*
- *sese për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetëlëvizëse.*
- *BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaroi përmbushjen e tyre.*

II.5. Në datën 13.03.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Shoqëria Kacdedja sh.p.k ka marrë pjesë si udhëheqës i bashkimit të operatorëve ekonomikë me shoqërinë Agri Construction sh.p.k në tenderin me objekt “Rivitalizim i rr Blv Blu Urbane Kamëz ku paraqitëm ofertë shumë të leverdisshme me vlerë 81,584,629 lekë pa tvsh. Në datën 08.03.2017 kemi marrë njoftimin nëpërmjet sistemit elektronik ku KVO-ja na ka skualifikuar me pretendime për të cilat paraqesim kundërshtimet tona të argumentuara si më poshtë dhe me dokumentacionin përkatës bashkëngjitur. Nga KVO pretendohet se –Operatori nuk ka paraqitur Nuk janë paraqitur listpagesat e muajit Janar 2017; Automjeti me targa AA348AG i ka skaduar afati i certifikatës së kontrollit teknik si dhe siguracioni; Automjeti me targa AA176 HJ është automjet tip fuoristrade; Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontratë huaje por që është dhënë nga qerramarrësi për qëllime bamirësie; BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer, Pirun, Makinerive televizësese për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetëlëvizëse.; BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaroi përmbushjen e tyre.*

Për sa më sipër ju bëjmë me dije se referuar shtojcës nr.10 tek pika 2 Kriteret e vecanta të kualifikimit të dst dhe konkretisht 2.3 kapaciteti teknik kërkohet nga autoriteti kontraktor: Kandidati ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën Janar2015-Dhjetor2016 ka pasur të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 90 punonjës (duke përfshirë edhe stafin tekniko menaxherial. Punëtorët të jenë të deklaruar me kohë të plotë. Për këtë dokumentacioni që duhet të paraqesë është: a) Vërtetim nga sigurimet shoqërore apo dega e tatimeve për numrin e të punësuarve dhe që u janë paguar detyrimet për kontributet e tyre për muajt e periudhës së mësipërme. b) Listpagesat e konfirmuara nga administrata tatimore për muajt e kësaj periudhe. Kjo arsye skualifikimi jo vetëm nuk qëndron por është në kundërshtim të hapur me nenin 55 pika 2 e LPP ku parashikohet se: Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në DT. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në DT, kjo për arsyen e thjeshtë sepse është një arsye apo kriter që nuk është kërkuar nga AK sepse fjalia operatori nuk ka paraqitur listpagesat e muajit Janar 2017 është një fjali e shtuar nga KVO dhe nuk parashikohet në kriteret për kualifikim.

- Nga KVO është konstatuar se automjeti me targë AA348AG i ka skaduar certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni. Konstatimi në lidhje me këtë mjet është i saktë por ju bëjmë me dije se po ti referohemi shtojcës 9 të hedhur në sistem nga shoqëria Kacdedja sh.p.k ky mjet ka emërtimin Rimorkiator dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues i mjetit rimorkiatorit mjet i cili nuk është kërkuar nga AK që do të thotë se konstatimi se i ka skaduar ose jo certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni nuk mund ta cojë AK në një vlerësim për mospërbushjen e kapacitetit teknik për një arsye të vetme sepse nuk e ka kërkuar Rimorkiatorin në DT.
- Nga KVO-ja pretendohet se automjeti me targë AA176HJ është automjet tip fuoristrade. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se pretendimi i KVO-së nuk qëndron sepse po ti referohemi lejes së qarkullimit të mjetit dhe konkretisht pika 23 dhe 24 e tij kuptohet qartë që kemi të bëjmë me një mjet me kapacitet mbajtës. Gjithashtu certifikata e kontrollit teknik e ka të përcaktuar qartë Kamion deri në 3.5 ton, dokument i lëshuar nga i vetmi institucion që bën kolaudimet e mjeteve në RSH. Shoqëria Kacdedja shpk ka hedhur në sistem këto kamioncina mjetet me targa AA 174 JD, AA479 EU, AA 305 GT, shoqëria Agri Construction shpk mjetet me targa TR8514 G (kapacitet 3.54 ton) TR 7967S (kapacitet 3.49). Nga bashkimi i operatorëve plotësohen dhe tejkalohen kapaciteti i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në DST nga ana juaj për tre kamioncina nga ana jonë janë paratur 5 kamioncina.
- Nga KVO pretendohet se : Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontartë huaje por që është dhënë nga qeramarrësi për qëllime bamirësie. BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer , Pirun, Makineri vetlëvizëse për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetlëvizëse. BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaroi përmbushjen e tyre. Pretendimet e KVO nuk qëndrojnë sepse kontrata e qerasë për automjetin AA305GT

është kontratë pa kundërshtim me shprehje vullneti të plotë nga qeradhënësi përpara noterit dhe nuk e kuptojmë se ku qëndron problemi dhe cila është arsyeja që e bën këtë kontratë të pavlefshme. Përcaktimi i shumës së pagesës apo mospërcaktimi fare i kësaj shume pagese vendoset me vullnetin e plotë të palëve në një kontratë qeraje. Kontrata e qerasë me nr.249 rep nr.230kol ka të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur për mjetet dhe buldozerin me faturën nr.110 të datës 30.12.2013 dhe së fundi bashkimi i operatorëve e përmbush numrin e pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Ne vlerësojmë se bashkimi i operatorëve Kacdedja shpk+Agri Construction sh.p.k disponojnë të gjitha kapacitetet, kualifikimet e nevojshme teknike , profesionale, organizative, makineritë, pajisjet e asete të cilat përmbushin kërkesat në raport me natyrën e punimeve dhe elementët konkretë të realizimit të zërave të preventivit që autoriteti kontraktor synon të arrijë në këtë procedurë prokurimi. Pretendimet e skualifikimit të KVO bie në kundërshtim me qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij duke frenuar konkurrencën dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit publik. Sa më sipër analizuar vlerësojmë se bashkimi i operatorëve ekonomikë Kacdedja sh.p.k dhe Agri Construction i ka përmbushur kriteret e kualifikimit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ligjore, financiare, dhe teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë prandaj justifikimi i KVO-së nuk mund të jetë argument që anashkalon ofertën tonë ekonomike me vlerë 81,584,629 lekë pa tvsh e cila rezultoi me cmimin më të ulët se oferta e kualifikuar pjesmarrëse në këtë tender duke i kursyer shtetit vlerën prej 4,365,432 lekë të reja. Për sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.

II.6. Në datën 15.03.2017, me shkresën nr. 1074/4 prot, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” sh.p.k është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 21.03.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr.1253/1 prot., datë 27.03.2017, protokolluar me tonën me nr.513/2 prot., datë 28.03.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8.1. Referuar informacionit të mësipërm, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka argumentuar se :Gjatë këtij afati ka patur ankesa nga operatori ekonomik “Kacdedja” shpk protokolluar me tonën nr.1074 prot datë 13.03.2017. Autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz në përfundim të shqyrtimit të ankesës e refuzoi atë dhe i ka kthyer përgjigje brenda afateve sipas shkresës me nr.1074/4 datë 15.03.2017. Njoftimi i fituesit me nr.81 prot datë 15.03.2017 është hedhur në sistem më datë 16.03.2017. Më datë 23.03.2017 është lidhur kontrata me nr.90 prot datë 23.03.2017”

II.9. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi “Njoftimin e Fituesit” në Sistemin e Prokurimeve Elektornike si edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike (BNJP) Nr.11, të datës 20.03.2017 faqe nr.237-238. Referuar Njoftimit të Fituesit, ndër të tjera, autoriteti kontraktor ka pasqyruar se për këtë procedurë prokurimi ka patur ankesa dhe më datë 15.03.2017 është dhënë përgjigje.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

III.1. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi “Njoftimin e Fituesit” në Sistemin e Prokurimeve Elektornike si edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike (BNJP) Nr.11, të datës 20.03.2017 faqe nr.237-238. Referuar Njoftimit të Fituesit, ndër të tjera, autoriteti kontraktor ka pasqyruar se për këtë procedurë prokurimi ka patur ankesa dhe më datë 15.03.2017 është dhënë përgjigje.

Në nenin 27 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të VKM nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; parashikohet se: “ [...]1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”. Sa më sipër, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton fillimisht ligjshmërinë e vendimeve të autoritetit kontraktor në drejtim të aktit administrativ për publikimin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz

III.1.1. Në datën 08.03.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Caushi	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku	79,037,818	I skualifikuar
- Sireta 2F&Alko Impex General Construction	80,000,000	I skualifikuar
- Kacdedja&Agri Construction	81,584,629	I skualifikuar
- BO Krajger Konstruktion&Varaku E	89,950,061	I kualifikuar

III.1.2. Në datën 13.03.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

- *Nuk janë paraqitur listpagesat e muajit Janar 2017*
- *Automjeti me targa AA348AG i ka skaduar afati i certifikatës së kontrollit teknik si dhe siguracioni*
- *Automjeti me targa AA176HJ është automjet tip fuoristrade.*
- *Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontratë huaje por që është dhënë nga qerramarrësi për qëllime bamirësie*
- *BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer, Pirun, Makinerive televizë*
- *sese për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetëlëvizëse.*
- *BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaron përmbushjen e tyre.*

III.1.3. Në datën 13.03.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.4. Në datën 15.03.2017, me shkresën nr. 1074/4 prot, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” sh.p.k është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

III.1.5. Në datën 21.03.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.1.7. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”

Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “ Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë

shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.”

Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në datën 15.03.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke refuzuar ankesën e tij. Me refuzimin e ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe dhënia e një vendimi të arsyetuar nga ky i fundit nuk heq pezullimin e procedurës së prokurimit parashikuar nga nenit 63 pika 3 e LPP. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduriale të ankimit duke vijuar me hapat e mëtejshëm të publikimit të njoftimit të fituesit, brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimes i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes ka qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë K.P.P si në momentin e publikimit të njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit gjithashtu edhe në momentin e dorëzimit të ankesës pranë KPP. Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 1253/1 protokoli datë 27.03.2017 autoriteti kontraktor ndër të tjera ka argumentuar se :*Gjatë këtij afati ka patur ankesa nga operatori ekonomik “Kacdedja” shpk protokolluar me tonën nr.1074 prot datë 13.03.2017. Autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz në përfundim të shqyrtimit të ankesës e refuzoi atë dhe i ka kthyer përgjigje brenda afateve sipas shkresës me nr.1074/4 datë 15.03.2017. Njoftimi i fituesit me nr.81 prot datë 15.03.2017 është hedhur në sistem më datë 16.03.2017. Më datë 23.03.2017 është lidhur kontrata me nr.90 prot datë 23.03.2017”*

III.1.9. Vendimi i autoritetit kontraktor për publikimin e njoftimit të fituesit me nr. 81 prot datë 15.03.2017 si edhe vendimi për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me lidhjen e kontratës është një akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) si *do shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, publikimit të njoftimit të fituesit dhe lidhjes së kontratës, kjo procedurë ka qenë e pezulluar. Në konceptin juridik *Pezullimi* është një moment juridik që ndërpret në mënyrë të menjëhershme dhe për një kohë të caktuar fuqinë

juridike të aktit (në rastin konkret veprimet e autoritetit kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit). Pezullimi i parashikuar nga neni 63 pika 3 e LPP-së është e lidhur ngushtësisht me afatin kohor të parashikuar nga neni 63 pika 6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka vijuar hapat në një procedurë prokurimi në fazën kur kjo e fundit ka qenë e pezulluar. Në nenin 58 pika 6 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikon se “Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ, sipas kreut VII të këtij ligji, e bën atë absolutisht të pavlefshme”. Në nenin 108 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo

një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.”

Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtet e konstatimit *prima facie* të një akti administrative absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrative më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 19/1 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, konstaton se aktet administrative të publikimit të njoftimit të fituesit dhe të lidhjes së kontratës të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest);

III.1.9. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.” autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për kthimin e palëve në gjendjen juridike fillestare.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “Nuk janë paraqitur listpagesat e muajit Janar 2017” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

a. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën Janar 2015- Dhjetor 2016, ka pasur të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 90 punonjës (duke përfshire edhe stafin tekniko menaxherial). Punëtorët të jenë të deklaruar me kohë të plotë.

Për këtë, dokumentacioni që duhet të paraqesë është:

a. Vërtetim nga sig shoqërore apo dega tatimeve për numrin e të punësuarve dhe që u janë paguar detyrimet për kontributet e tyre për muaj e periudhës së mësipërme ,

b. Liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore për muajt e kësaj periudhe

III.2.2.. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.2.3. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Në nenin 28 pika 5 gërma “ç” “Kontratat e Shërbimeve” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*, ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*. Neni 55 pika 2 e LPP-së parashikon se *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”*. Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ *quazi gjyqësor* dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”*, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor në drejtim të plotësimit të dëshmisë së fuqisë punëtore ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik detyrimin për dorëzimin e listëpagesave për peirudhën *Janar 2015- Dhjetor 2016*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë rast dorëzimin e listëpagesave të muajit Janar 2017. KPP gjykon se në cilësinë e një organi *quazi gjyqësor*, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës *Judicis est judicare secundum allegata et probate (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces)* . KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi kritere të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e garës.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tyre me argumentet se “

- Automjeti me targa AA348AG i ka skaduar afati i certifikatës së kontrollit teknik si dhe siguracioni
- Automjeti me targa AA176HJ është automjet tip fuoristrade.
- Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontratë huaje por që është dhënë nga qerramarrësi për qëllime bamirësie
- BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer, Pirun, Makinerive televizësese për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetëlëvizëse.
- BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaron përmbushjen e tyre.”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

- ❖ Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet transporti veteshkarkuese	12 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine veteshkarkues (minimumi 1.5-5Ton)	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	5 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me gome	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome me fshese (bobcat)	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes gome hekur-hekur 6 - 12 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes hekur-hekur 4 - 12 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes asfalti hekur -gome	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes hekur - hekur	2 copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfalto shtruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Autofshese	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per sperkatje bitumi	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri vetlevizese per prerje bari dhe vegjetacioni	1 copë	Pronësi ose me qera
Auto-Vinc me aftesi mbajttese 13 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Pirun(min 6 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonjere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe	1 copë	Pronësi ose me qera

Sharre asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per vijezim biokomponente	1 copë	Pronësi ose me qera
Semafor i levizshem	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Asfalti per prodhim Asfalt Rubber ASTM D6114(asfalt i gomuar)	1 copë	Pronësi ose me qera
Nyje per thyerje inertesh vetelevizese	1 copë	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit si me poshte:

- Kokore minimum 30 cope.
- Fiksezjarritelevizshme me kapacitet 5-7 litraseciliminimumi 3 cope.
- Prozhektorendriçiminatenminimumi 3 cope.
- Komplotiindhmes se shpejte minimum 5 cope.

Pronesia e mjeteve te mesiperme te vertetohet si me poshte :

Ofertuesi duhet te paraqesë per makinerite te cilat jane ne pronesi, lejet e qarkullimit te tyre (te cilat duhet te jene ne emer te shoqerise), çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionini vlefshem , taksat vjetore dhe leja e transportit nga bashkia (te vlefshme), tahograf, çertifikaten e pronesise.si dhe fotot e tyre. Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk kane leje qarkullimi Ofertuesi duhet te paraqesë kontrate noteriale te blerjes, ose fatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te mjetit.

Pranohet marrja me qira ose huaperdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontratat e qiramarrjes ose te huaperdorjes te jene te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt.

- Per fabriken e asfaltit ne rast se jane ne pronesioperatoritekonomikduhetshoqerohet me dokumentacioninperkates, dokumentin e pronesise, lejen e mjedisoreteleshuarnga QKL
- Per fabriken e betonit ne rast se jane ne pronesioperatoritekonomikduhetshoqerohet me dokumentacioninperkates, dokumentin e pronesise, lejen e mjedisoreteleshuarnga QKL
- Per fabriken e asfaltit e betonitkurnukjane ne pronesioperatoritteparaqesinketodokumenta: kontratenoteriaketeqerase,dokumentin e pronesise, lejenmjedisoreteleshuarnga QKL.

Shënim :

- a) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit.
- b) Ofertuesi se bashku me dokumentat e mesiperm duhet te paraqese te plotesuar e te nenshkruar edhe Formularin sipas Shtojces 9 te DST.

c) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vëndndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

III.3.3. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

III.3.4. Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në lidhje me arsyet e mësipërme të kualifikimit, *inter alia* operatori ekonomik ankimues ka argumentuar se *“Nga KVO është konstatuar se automjeti me targë AA348AG i ka skaduar certifikata e kontrollit teknik dhe siguraconi. Konstatimi në lidhje me këtë mjet është i saktë por ju bëjmë me dije se po ti referohemi shtojcës 9 të hedhur në sistem nga shoqëria Kacdedja sh.p.k ky mjet ka emërtimin Rimorkiator dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues i mjetit rimorkiatorit mjet i cili nuk është kërkuar nga AK që do të thotë se konstatimi se i ka skaduar ose jo certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni nuk mund ta cojë AK në një vlerësim për mospërmbushjen e kapacitetit teknik për një arsye të vetme sepse nuk e ka kërkuar Rimorkiatorin në DT.; Nga KVO-ja pretendohet se automjeti me targë AA176HJ është automjet tip fuoristrade. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se pretendimi i KVO-së nuk qëndron sepse po ti referohemi lejes së qarkullimit të mjetit dhe konkretisht pika 23 dhe 24 e tij kuptohet qartë që kemi të bëjmë me një mjet me kapacitet mbajtës. Gjithashtu certifikata e kontrollit teknik e ka të përcaktuar qartë Kamion deri në 3.5 ton, dokument i lëshuar nga i vetmi institucion që bën kolaudimet e mjeteve në RSH. Shoqëria Kacdedja shpk ka hedhur në sistem këto kamioncina mjetet me targa AA 174 JD, AA479 EU, AA 305 GT, shoqëria Agri Construction shpk mjetet me targa TR8514 G (kapacitet 3.54 ton) TR 7967S (kapacitet 3.49). Nga bashkimi i operatorëve plotësohen dhe tejkalohen kapaciteti i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në DST nga ana juaj për tre kamioncina nga ana jonë janë paraitur 5 kamioncina”* Në lidhje me mjetin me targë AA348 AG, me Nr. Leje Qarkullimi TRDA3031716 dhe Nr. Shasie Mjeti VVMAT371746M211305 mjet i deklaruar i disponueshëm me anë të kontratës së qerasë nr. 12754 Rep dhe nr. 794 Kol, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar “Shtojcës 9” mbi *“Disponueshmërinë e mjeteve”*, mjeti i mësipërm është deklaruar nga anëtarë i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk me përshkrim “*lloji mjetit*” “*Rimorkiator*”. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, shtojcës 10 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës deklarin e disponueshmërisë së mjetit tip rimorkiator.

III.3.5. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me*

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”, ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Neni 55 pika 2 e LPP-së parashikon se “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ *quazi gjyqësor* dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP gjykon se përsa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar deklarin e mjetit tip *“rimorkiator”* të disponueshëm në dokumentet e procedurës së prokurimit, ky i fundit (KPP) nuk mund të vlerësojë, gjykojë në rast se mjeti i dorëzuar rishtaz nga operatori ekonomik ankimues përmbush kapacitetin teknik dhe/ose është i shoqëruar me dokumentacionin e vlefshëm ligjor në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.3.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se *“Për automjetin me targë AA305GT është paraqitur kontratë huaje por që është dhënë nga qerramarrësi për qëllime bamirësie”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues mbi vlefshmërinë e disponimit të mjeteve në përdorim me anë të kontratave noteriale të huapërdorjes nga njëra anë dhe pretendimit nga ana tjetër të autoritetit kontraktor mbi ligjshmërinë e kontratës së sipërcituar, KPP vlerëson të sqarojë se, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimiti objekt ankimi, shtojcës mbi kriteret e veçanta të kualifikimit, në lidhje me provueshmërinë e mjeteve, *inter allia* autoriteti kontraktor ka parashikuar se *“Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontratat e qiramarrjes ose te huapërdorjes te jene te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt.”* Sa më sipër, KPP nënvizon se me anë të parashikimit të mësipër, autoriteti kontraktor ka pranuar dorëzimin e dokumentacionit provues mbi disponueshmërinë e mjeteve të sipërcituar (pa diferencuar natyrën e mjeteve) edhe dorëzimin e kontratave të huapërdorjes së tyre. KPP gjykon se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon se zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk ndër të tjera në drejtim të proveushmërisë së kapacitetit teknik për mjetet e tipit *kamion* ka dorëzuar ndër të tjera edhe kontratën e qerasë të lidhur para noterit publik në Republikën e Shqipërisë nr.1971/1 rep dhe nr.778/1 kol datë 09.06.2014. Referuar aktit noterial të mësipërm, KPP konstaton se kontrata e mësipërme është hartuar në përputhje me nenin 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bazë ligjore e së cilës lidhet me hartimin e kontratave të qirasë. Akoma më tej, KPP nënvizon se në rastin konkret vetë autoriteti kontraktor i ka dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë kontrata huapërdorje mjeti (pa kundërshtim), pasqyruar kjo në kriteret e veçanta të kualifikimit, duke dhënë njëherazi, në respekt të parimit të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve edhe pritshmërinë se shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të sipërcituar do të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “*Automjeti me targa AA176HJ është automjet tip fuoristrade*” Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e të dy anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, operatori ekonomik “Kacdedja” shpk dhe operatori ekonomik “Agri Construction” shpk, shtojcës 9 “*Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve*” të lëshuar respektivisht nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, si edhe njëherazi dokumentacionit teknik dhe ligjor të dorëzuar në SPE nga këta dy të fundit, në asnjë rast nuk është dorëzuar apo dhe deklaruar si i disponueshëm mjet me targa AA 176 HJ. Sa më sipër, KPP gjykon se, përsa kohë nga asnjë prej anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk është dorëzuar mjeti me targë AA 176 HJ, sëbashku me dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të gjykojë dhe vlerësojë mbi plotësimin e kërkesave teknike dhe funksionale të mjetit të sipërcituar. KPP konstaton se mjeti me targë AA 173 HJ, i deklaruar si kamioncinë nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Agri Consturction:” shpk është një mjet i ndryshëm nga mjeti të cilit i referohet autoriteti kontraktor në arsyetimin e skualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.3.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “*-BO nuk ka paraqitur dokumentacion për Bolduzer, Pirun, Makinerive televizësese për prerje bari dhe vegjetacioni si dhe nyje për thyerje inertesh vetëlëvizëse.*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.9.1. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, Shtojca 10 “ Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti Teknik” ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar [...]”

III.3.9.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitetet e deklaruar dhe të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik thekson se me angazhimin në dorëzimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe dorëzimin e ofertave ekonomike, teknike dhe ligjore, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë deklaruar njëherazi disponueshmërinë e mjeteve të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në funksion të angazhimit në realizimin e kontratës në rast të fitimit të saj. Sa më sipër, KPP vlerëson se në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave ekonomike dhe teknike në procedurat e prokurimit publik, autoriteti kontraktor në cilësinë e institucionit përgjegjës për mirëmenaxhimin e fondeve publike nuk duhet të kufizohet vetëm në shqyrtimin e shtocjës 9 “Mbi disponueshmërinë e mjeteve” duke vlerësuar kështu në mënyrë sipërfaqësore kapacitetin e operatorëve ekonomikë, por duhet të shqyrtojë në tërësi dokumentacionin e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke shqyrtuar, vlerësuar dhe krahasuar ofertat në tërësi me dokumentacionin e dorëzuar, pa u kufizuar por jo vetëm, në deklarimin e mjeteve në shtojcën mbi disponueshmërinë e mjeteve, si edhe në kufizime mbi emërtimet e përshkrimit të këtyre të fundit duke vlerësuar mbi funksionin bazë dhe qëllimin e kërkimit të këtyre të fundit, kjo në respekt të nenit 46 pika 1 të *lex specialis* si edhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet se *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.3.9.3. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi të dorëzuar nga ana bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, KPP konstaton se ndër të tjera, operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, edhe Faturën Tatimore të Shitjes nr. 356 datë 27.04.2016 në të cilën konstatohet se shoqëria “Kacdedja” shpk në cilësinë e blerësit, disponon në pronësi të saj mjetin/paisjen me përshkrim kullë për punime në rrugë me ngritje vertikle me kosh pesha 200 kg e lart, ndërkohë anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Faturën Tatimore të

Shitjes nr. 20 datë 17.07.2010 në të cilën konstatohet se shoqëria “Agri Construction” shpk në cilësinë e blerësit, disponon në pronësi të tij mjetin/paisjen me përshkrim *vinç kullë 21 ton h =12*. KPP gjykon se mjetet e mësipërme referuar përshkrimit dhe funksionit të tyre, kapacitetit teknik përmbushin kriterin mbi disponueshmërinë e mjetit tip *pirun*, si mjete me funksion ngritje në lartësi dhe me kapacitet (peshë) më e madhe se ajo e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Ndërkohë, KPP konstaton se referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ndër të tjera, anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Agri Construction” shpk ndër të tjera ka dorëzuar edhe Faturën Tatimore të Shitjes nr 153 datë 03.06.2013 ku ndër të tjera konstatohet se disponon në pronësi në cilësinë e blerësit, mjetin/paisjen sharrë për prerje në sasi 2 copë, mjet i cili referuar përshkrimit dhe funksionit të tyre, kapacitetit teknik përmbushin kriterin mbi disponueshmërinë e mjetit tip *“makineri vetlëvizëse për prerje bari dhe vegjetacioni”*. Ndërkohë, KPP konstaton se referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ndër të tjera, anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk ndër të tjera ka dorëzuar edhe kontratën nr.506 kol dhe nr.393 rep datë 19.01.2017 lidhur para noterit publik në Republikën e Shqipërisë dhe mes shoqërisë “Kacdedja” shpk dhe shoqërisë “Company Riviera 2008” shpk me objekt *furnizim inerte me fraksione të ndryshme*, shoqëruar me dokumentacion provues mbi disponueshmërinë e linjës së inerteve nga ana e furnizuesit si edhe njëherazi me QKL. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Në nenin 26 “Kontratat për punë publike”, pika 8 gërma “c” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një interpretim të zgjeruar të nenit 46 pika 1 gërma “b” të LPP-së dhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të aktit normative në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) i nenit 46 pika 1*

gërma “b” K.P.P. gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me anë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të vërtetohet plotësimi i kapacitetit teknik të tyre në drejtim të *kapaciteteve organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative* për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Akoma më tej në nenin 26 pika 8 gërma “c”, parashikohet se për përmbushjen e kapacitetit teknik operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dëshmi për mjete dhe paisje pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore duke iu referuar vetëm regjimit juridik të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, në rast se me anë të dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se ka në pronësi, qera apo disponueshmëri me mjete të tjera juridike të paisjeve dhe aseteve të cilat ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion për zbatimin me sukses të kontratës. Sa më sipër, KPP gjykon se me anë të dokumentacionit të mësipërm të dorëzuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë përmbush kriterin e kërkuar mbi disponueshmërinë e *Nyje per thyerje inertesh vetelevizese*. Në lidhje me pretendimin për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes me arsyetimin se nuk disponojnë mjetin tip *buldozer*, KPP konstaton se referuar shtojcës 9 “*Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve*”, anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Agri Construction” shpk ndër të tjera ka deklaruar edhe disponueshmërinë e mjetit tip “*Fadrome APV Caterpillar*” me targë TR 6710 R me nr. Leje qarkullimi TR 0085186 dhe me nr. Shasie 2CR19859, për të cilin në seksionin “*të tjera*” të shtojcës ka deklaruar se kryen “*4 funksione (Edhe matrapik)*”, mjet i shoqëruar me dokumentacion të vlefshëm. Referuar mejtit të mësipërm, KPP gjykon se mjeti i mësipërm, referuar funksionit bazë si edhe faktit se ky i fundit përmban funksione shtesë duke kryer 4 funksione njëherazi dhe qëllimin e kërimit të këtyre të fundit (mjeteve) nga ana e autoritetit kontraktor është mjet i vlefshëm/ekuivalent me mjetin tip *buldozer* të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se “*BO nuk përmbush numrin e makinerive të kërkuara në tender pavarësisht se deklaron përmbushjen e tyre*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga analizimi në tërësi i arsyes së mësipërme të skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka qartësuar pretendimin e tij mbi mosplotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, duke mos identifikuar se për cilin mjet/paisje ngrihen pretendime dhe cilat janë mospërputhjet paisjeve të propozuara me ato të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa kohë që pretendimi i autoritetit nuk shfaqet i qartë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të vlerësojë mbi arsyetime të paqarta që përmbajnë të dhëna kontradiktore në të cilat nuk identifikohet se për cilin mjet/paisje shfaqen paqartësi. Akoma më tej, KPP konstaton se në kriteret e veçanta të kualifikimit, ndër të tjera është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dorëzojnë “*deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi*”. Referuar dokumentacionit të administruar, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka kryer verifikimin e mjeteve të deklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Kacdedja” sh.p.k & “Agri Construction” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-66246-01-31-2017 me objekt: “Rivitalizim i rrugës “Blv Blu” Urbane Kamëz”, me fond limit 86,818,451 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 24.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative mbi Njoftimin e Fituesit të operatorit ekonomik “Klajger Konstruksion” shpk si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji.
3. Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme për kthimin e palëve në gjendjen juridike fillestare.
4. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k. & “Agri Construction” shpk dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k. & “Agri Construction” shpk
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 513 Protokolli; Datë 21.03.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha